

---

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“SOLTECH-AL” Sh.p.k.**

---

**AKT- THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“SOLTECH-AL” Sh.p.k.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **“SOLTECH-AL” Sh.p.k.** dhe me emer tregtare **“SOLTECH-AL”**, zoterohet nga ortaku:

- 1. ZNJ. VLORA DESHISHKU, atesia CAUSH, lindur me 01.10.1972, ne Prishtine, dhe banuese ne Prishtine, Kosove, mbajtes i kartes se identitetit me Nr. 1001066028.**

Në përputhje me vullnetin e tij te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendosi të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë **“SOLTECH-AL” Sh.p.k.** mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1**  
**FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise **“SOLTECH-AL” Sh.p.k.**

**NENI 2**  
**BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

**NENI 3**  
**SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga Norbert Jokl, Ndertesa Nr. 2, Hyrja 1, Njesia Administrative Nr. 2, Tirane.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

#### **NENI 4**

### **KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE**

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria priset dhe kalon në procedure likujdimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

#### **NENI 5**

### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Shoqeria " **SOLTECH-AL** " sh.p.k është e organizuar ne formen e nje shoqerie qe merret me:

1 - Import - eksport dhe/ose tregëtia ne vecanti e pajisjeve elektrike, elektronike, elektro-shtepiake, kancelari etj. Shitja me shumice dhe/ose pakice, edhe nepermjet platformave online, e produkteve, ne vecanti e pajisjeve elektrike, elektronike, elektro-shtepiake, kancelari etj.

2 - Gjithashtu, Shoqeria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie apo transaksioni tjeter qe lidhet me pasuri te luajtshme e te paluajtshme, me kryerjen e veprimeve tregtare, industriale, dhe/ose financiare te cfaredo lloji dhe natyre, te nevojshme ose te dobishme per arritjen dhe ose plotesimin e objektivit te Shoqerise, qe nuk ndryshojne aktivitetin paresor te Shoqerise dhe nuk bie ne kundërshtim me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

#### **NENI 6**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 Leke (njqindmije Leke), i ndare në 1 (nje) pjese. Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

- 1 - ZNJ. VLORA DESHISHKU, atesia CAUSH, lindur me 01.10.1972, ne Prishtine, dhe banuese ne Prishtine, Kosove, mbajtes i kartes se identitetit me Nr. 1001066028 me nje kuote te barabarte me 100 %te kapitalit me vlere 100.000 Lekë (njëqindmijë).**

Kapitali themeltar i shoqërise do të shlyet tërësisht dhe depozitohet ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

#### **NENI 7**

## **AKTET E SHOQERISE**

Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij akt-themelimi edhe me norma të përcaktuara në statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërisë dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërisë.

### **NENI 8**

#### **ORGANET DREJTUESE**

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shumë se një administrator edhe pse nuk është ortak. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërisë “**SOLTECH-AL**” Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administrator i shoqërisë për një periudhë 5 (pese) vjeçare, është emëruar: **ZNJ. VLORA DESHISHKU, atesia CAUSH, lindur me 01.10.1972, në Prishtinë, dhe banuese në Prishtinë, Kosovë, mbajtes i kartës së identitetit me Nr. 1001066028.**

### **NENI 9**

#### **DISPOZITAT E FUNDIT**

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tirane.

Ky akt themelim është hartuar në 2 (dy) ne gjuhen shqipe duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

**Tirane, 06.04.2024**

#### **ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

**“SOLTECH-AL” Sh.p.k.**

**VLORA DESHISHKU**



**V.D.**